



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 345/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me rinumërimin e votave të pavlefshme, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014 mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 11.06.2014, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR në të cilin kërkon nga PZAP- i që të marrë vendim për rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme, pasi që siç theksohet në ankesë KQZ-ja për rezultatet preliminare ka shpallur të pa vlefshme 39.797 fletëvotime (K-vote) e që sipas parashtruesit të ankesës paraqesin mbi 6% të të gjithë votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje. Këto veprime sipas AKR-së janë kryer përshkak që siç thuhet mungesës së njohurive me procesin nga anëtarët e KVV-ve. AKR më tutje thekson se ka informata se një numër i fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme nga KVV-të janë vota për subjektin politik AKR dhe se përmes rinumërimit të këtyre fletëvotimeve do të respektohet vullneti i votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi ankesën në fjalë gjeti se ankesa është e palejuar pasi që me publikimin e rezultateve përfundimtare publikohen të gjitha fletëvotimet, si fletëvotimet e pavlefshme ashtu edhe ato të vlefshme, dhe meqenëse në këtë fazë të procesit zgjedhor në vazhdimësi janë duke u publikuar rezultatet K-

vote” në web faqe, këto rezultate nuk janë përfundimtare, janë fleksibile dhe janë të ndryshueshme në çdo moment.

Andaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 345/2014 më datën 12.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,*